



# Ndërtimi i bazës për reformën në sektorin e duhanit



IPA Programi i Bashkimit Evropian TAIB 2013  
EUROPEAID/138538/IH/SER/MK

## Shpallje publike për pjesëmarrje në pilot aktivitete për diversifikim dhe përmirësim të efikasitetit të ekonomive bujqësore në Maqedoni

Në kuadër të instrumentit të ndihmës së para aderimit (IPA Komponenti 1), në janar 2018, konzorciumi Evoluxer në partneritet me Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë të ujërave filloi me realizimin e projektit “Ndërtimi i bazës për reformën në sektorin e duhanit” i financuar nga Bashkimi Evropian.

Synimi kryesor i këtij projekti është që të kontribuojë në adaptimin e sektorit të duhanit në drejtim të një politike të përbashkët bujqësore (PPB) dhe rregullores të BE-së. Në drejtim të arritjes të këtij synimi kryesor, projekti është strukturuar në 5 aktivitete, nga të cilat aktiviteti numër 3 ka për qëllim që të realizojë përzgjedhjen e pjesëmarrësve për pilot aktivitetet, siç është përshkruar në vijim:

*Aktiviteti 3: Projektimi i pilot aktiviteteve për diversifikimin e të ardhurave të realizuara nga prodhimi i duhanit, me futjen e kulturave alternative dhe/ose rritjen e efikasitetit të prodhimit të duhanit.*

Shpallja i referohet ekonomive bujqësore, prodhues të duhanit që do të dëshironin me vullnet të tyre të marrin pjesë në aktivitetet e projektit, **më saktësisht në kuadër të aktivitetit 3 që kanë tokë në pronësi apo në posedim.**

Mbështetje për implementimin e pilot aktiviteteve do të sigurohet nga ana e projektit, përmes angazhimit të ekspertëve nga fusha, të cilët do të kenë për detyrë realizimin e aktivitetit dhe kryerjen e mbikqyrjes në terren. Do të realizohen 40 pilot aktivitete të cilat do të vijojnë në periudha të ndryshme të vitit (2018-2019). Projekti do të sigurojë materialin





# Ndërtimi i bazës për reformën në sektorin e duhanit



IPA Programi i Bashkimit Evropian TAIB 2013  
EUROPEAID/138538/IH/SER/MK

farë (farën), repromateriale, dhe të gjitha llojet e furnizimeve tjera që janë të nevojshme për realizimin përkatës të pilot aktiviteteve.

## Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e pilot ekonomive

Kriteret që duhet të merren parasysh gjatë përzgjedhjes të ekonomive bujqësore përkatëse për pilot aktivitetet janë:

- Lokacioni i ekonomisë bujqësore (Prilep, Manastir, Radovish, të tjera)
- Statusi (Prodhues/ndërmarrje private individual/e bujqësor/e (i/e duhanit)
- Sipërfaqe në të cilën kultivohet duhani (të paktën 0,2 ha)
- Lloji i duhanit të kultivuar
- Rotacioni me kulturat tjera
- Lloji i bagëtisë: viç, dhen, dhi (me kusht të paktën 2 krerë bagëti të mëdha dhe me kusht që 5 krerë bagëti të vogla)
- Sipërfaqja e cila ujitet (minimum 0,05 ha)
- Mekanizimi dhe pajisja në shfrytëzim (makinë për mbjellje të duhanit, spërkatëse për mbrojtje, mbjellës hidraulik për kultura të drithërave dhe/ose kultura furazhe, të tjera)
- Punë dore në dispozicion

Formulari për aplikim mund të merret në këtë link:

[Aplikim](#)

Në kuadër të shpërndarjes gjeografike të pilot aktiviteteve, do të validohen kushtet klimatike të përshtatshme për kultivim të duhanit dhe kulturave tjera.





# Ndërtimi i bazës për reformën në sektorin e duhanit



IPA Programi i Bashkimit Evropian TAIB 2013  
EUROPEAID/138538/IH/SER/MK

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore për pilot aktivitetet duhet të jetë me sipërfaqe minimale 0.4 ha prej të cilave tokë në dispozicion për pilot aktivitetet është minimum 0,2 ha, të evidentuara në regjistrat e MBPEU.

Ujitja do të ketë përparësi gjatë përzgjedhjes të pilot ekonomive bujqësore. Ato ekonomi bujqësore që disponojnë me mekanizim bujqësor të përmendur më sipër te kriteret, do të kenë përparësi gjatë përzgjedhjes.

Për realizimin e pilot aktiviteteve duhet fugi punëtores të cilën komisioni i përzgjedhjes do ta verifikojë me deklaratë për disponueshmëri të një personi i cili do të angazhohet për pilot aktivitetin me të cilin projekti do të lidh kontratë.

Përzgjedhja e pjesmarrësve do të bëhet nga komisioni për përzgjedhje që është formuar për nevojat e këtij aktiviteti të projektit. Aplikimet respektivisht fletëparaqitjet do të shqyrtohen në afat prej 7 ditësh pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve. Sipas kriterëve të përcaktuara në mënyrë të qartë është paraparë përzgjedhja e 40 aplikantëve – ekonomi bujqësore, prodhues të duhanit, të cilëve do u jepet mbështetje gjatë implementimit të projektit. Përparësi gjatë përzgjedhjes do të kenë ato ekonomi bujqësore që janë pjesë e sistemit FADN.

Me të gjithë ekonomitë bujqësore të përzgjedhura, prodhues të duhanit, do të nënshkruhet kontratë ku do të precizohen të drejtat dhe detyrimet për të gjithë nënshkruesit.

**Të gjithë ekonomitë bujqësore/prodhues të duhanit që janë të interesuar/a, për informata shtesë mund të drejtohen në numrin e telefonit 02/3134-477, lokal 707 dhe 02/3134-477, lokal 55. Aplikimi për pjesmarrje mund të merret në faqen e internetit ku është publikuar <http://www.mzsv.gov.mk/>,**





# Ndërtimi i bazës për reformën në sektorin e duhanit



IPA Programi i Bashkimit Evropian TAIB 2013  
EUROPEAID/138538/IH/SER/MK

<https://www.finance.gov.mk/>, <http://agencija.gov.mk/> apo të merret në formë të shpyr drejtëpërdrejtë në zyrën projektuese (220) në ndërtesën e Ministrisë të bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë të ujërave. Pranimi dhe regjistrimi i aplikimeve të plotësuar do të bëhen në zyrën projektuese, nga 17 gushti deri në 17 shtator, prej orës 09.00 deri në orën 15.00 apo të dërgohen me postë në adresën “Aminta treti” nr 2, 1000, Shkup me shënim për pjesmarrje në projektin “Ndërtimi i bazës për reformën në sektorin e duhanit” – zyra numër 220.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit në verzionin e shtypur në letër është 17 shtator 2018, deri në ora 15:00

\*Gjatë procesit të përzgjedhjes, komisioni mund të kërkojë nga pjesëmarrësit dokumentacion si dëshmi për atë që është deklaruar në këtë dokument.

